

PROCESVERBAL
nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 26.2.2026

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, mr. Gordana Majnova, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski (pushim vjetor).

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska, Vesna Simonovska, Ivana Nikić.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 8-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të vazhdimit të parë të seancës së 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 18.2.2026.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 3-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 18.2.2026.
3. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 7-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 18.2.2026.
4. Raport mbi Llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025 me Propozim-vendim për miratimin e Llogarisë vjetore.
5. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Top Estrada ShPKNJ Tetovë.
6. Propozim për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv.
7. Informacion mbi pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2026.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe me 5 vota "pro" dhe një votë "abstenim" nga Afrona Vërzivolli miratoi Procesverbalin e propozuar të vazhdimin të parë të seancës së 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 18.2.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe me 5 vota "pro" dhe një votë "abstenim" nga Afrona Vërzivolli miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së tretë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 18.2.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Këshilli shqyrtoi dhe me 5 vota "pro" dhe një votë "abstenim" nga Afrona Vërzivolli miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 7-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 18.2.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Raportin mbi Llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025. Ai shpjegoi se, në pajtim me Ligjin për kontabilitet për organizatat jofitimprurëse, Agjencia është e detyruar llogarinë vjetore për vitin 2025, ta dorëzojë jo më vonë se 28 shkurt të vitit aktual. Ai deklaroi se të ardhurat totale të realizuara në vitin 2025 arritën në 141.336.000,00 denarë. Pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave, përkatësisht 74.117.431,00 denarë (52,44%), janë mjete për financimin e veprimtaris radiodifuzive nga Buxheti i RMV-së. Mjetet e paguara janë 5.000.000,00 denarë më pak se mjetet e parashikuara me ligj të destinuar për financimin e Agjencisë. Pastaj, të ardhurat nga Buxheti për aktivitetet zgjedhore që u zhvilluan në vitin 2025 (zgjedhjet lokale) në shumën prej 7.581.728,00 denarë. Nga lejet për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive u realizuan në total të ardhura prej 47.495.388,00 denarësh, ndërsa nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore dhe shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë u realizuan të ardhura prej 10.751.766,00 denarësh. Të ardhurat e mbetura u realizuan nga faturat tranzite në shumë prej 1.072.760,00 denarë, mjete të marra nga Ministria e Sportit dhe Ndërmarrja për menaxhimin e hapësirës banesore dhe afariste, mirëmbajtjen në vijim dhe furnizimine publik në grup për mirëmbajtje të objektit në të cilën ndodhet Agjencia dhe të ardhura të tjera në shumën prej 316.927,00 denarë. Shpenzimet e realizuara në total në vitin 2025 arrijnë në 146.963.388,00 denarë. Kjo rezulton se është realizuar një rezultat negativ financiar prej 5.627.368,00 denarë. Shpenzimet më të mëdha janë për pagesën e pagave bruto të punonjësve në shumë prej 91.679.888,00 denarë (62,38%) të shpenzimeve totale. Shpenzime të tjera të mëdha kanë të bëjnë me servisimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të Agjencisë në shumë prej 9.922.566,00 denarë, shpenzime për punësimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm përmes Agjencie për punësim të përkohshëm, për angazhimin e byrosë për përkthimi, për mirëmbajtjen e higjienës në ambientet afariste në shumë prej 10.598.600,00 denarë, kompensim për anëtarët e Këshillit të Agjencisë për 6 muajt e parë në shumë prej 6.059.098,00 denarë, shpenzime për konsumim të energjisë elektrike

dhe energjisë për ngrohje në shumë prej 3.391.995,00 denarë. Kërkesat në total të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas llogarisë vjetore për vitin 2025 arrijnë në 1.925.823,00 denarë dhe kryesisht kanë të bëjnë me faturat e viteve të mëparshme. Detyrimet totale ndaj kreditorëve arrijnë në 1.128.058,00 denarë dhe kanë të bëjnë me detyrimet e papaguara në janar 2026. Vlera kontabël e aseteve bazë (fikse) në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në fund të vitit 2025 arrin në 299.451.458,00,00 denarë. Në vitin 2026, u transferuan mjete në vlerë prej 129.153.508,00 denarë.

Në diskutim, këshilltarja Cvetanka Minovska kërkoi sqarime në lidhje me mjetet e destinuara për sigurimin shëndetësor privat në vitin 2025, të cilat nuk u realizuan, dhe nëse mjetet do të barten në vitin 2026.

Drejtori Trajčevski shpjegoi se mjetet ishin planifikuar në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025 dhe ishin përfshirë në Planin për furnizim publik për të njëjtin vit. Duke qenë se ato nuk u realizuan, mjetet do transferohen në Planin Financiar për vitin 2026, por në Planin për furnizim publik për vitin 2026 nuk janë parashikuar, sepse të punësuarit nuk shprehën interes për shfrytëzim të sigurimit shëndetësor privat.

Këshilltarja Minovska bëri edhe një pyetje në lidhje me zbatimin e projektit për efikasitet energjetik, i financuar nga një donacion nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për ShPP "13 Nëntori" Shkup, dhe nëse nga donacioni ka ndonjë përfitim konkret.

Drejtori Trajčevski informoi se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dy herë i është drejtuar institucionit me shkresë me shkrim, ku përgjigja e marrë është se projekti ende nuk është realizuar. Ai gjithashtu propozoi të mbahet një takim me anëtarët e Këshillit për të diskutuar në mënyrë më të detajuar për këtë temë.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga kërkoi shpjegim më të detajuar në lidhje me pagesën jo të plotë të mjeteve të përcaktuara me ligj në shumë prej 5 milionë denarësh dhe pyeti nëse kjo situatë mund të paraqesë rrezik sistematik për financimin e qëndrueshëm dhe pavarësinë institucionale të organit rregullator. Ajo theksoi se Këshilli ka detyrim këtë çështje ta shënojë jo vetëm si një konstatim të gjendjes faktike (aktuale), por edhe si rrezik potencial që nuk duhet të bëhet praktikë në të ardhmen. Në këtë drejtim, ajo pyeti nëse është e nevojshme të dërgohet paralajmërim i brendshëm në Ministrinë e Financave me qëllim që të theksohet rëndësia e sigurimit të plotë dhe në kohë të mjeteve (fondeve) të përcaktuara me ligj.

Drejtori Trajčevski shpjegoi se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale i është drejtuar dy herë me shkresë zyrtare Ministrisë së Financave, por pa përgjigje. Ai theksoi se rast i tillë i mospagesës së fondeve të siguruara me ligj ka ndodhur edhe në vitet e mëparshme. Në koordinim me zyrën e avokatëve, Agjencia me shumë mundësi do t'i drejtohet përsëri Ministrisë me shkresë dhe paralajmërim para se të ngrejë padi. Nëse nuk ndërmerren aktivitete nga Ministria, Agjencia do të detyrohet që mjetet (fondet) në shumën prej 5 milionë denarësh t'i kërkojë përmes gjykatës. Nëse vihet deri në këtë fazë dhe fondet nuk paguhen nga Ministria, Këshilli i Agjencisë do të informohet me kohë dhe do të marrë vendim të përshtatshëm për hapat e mëtejshëm.

Këshilltarja Jajaga pyeti se nëse nuk paguhen mjetet në shumë prej 5 milionë denarëve, deri në ç'masë do ta vinte në rrezik funksionimin e organit rregullator dhe pavarësinë e institucionit.

Drejtori Trajçevski shpjegoi se 5 milionë denarë të papaguar janë arsyeja pse Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele tregoi rezultat negativ financiar. Ai shtoi se Buxheti i shtetit për vitin 2026 ka parashikuar më pak fonde për të gjithë aktivitetin, përfshirë edhe për Agjencinë. Në këtë pikë, Ministria e Financave për dy muajt e parë të vitit 2026 ka paguar mjete në shumë që korrespondon me shumën e planifikuar për vitin 2026. Megjithatë, nëse praktika e mospagesës vazhdon dhe nuk kryhet ribalanc i buxhetit, shuma e borxhit do të rritet, kështu që pritet në fund të vitit 2026 përsëri do t'i detyrohen Agjencisë së paku 5 milionë denarë dhe ndoshta edhe më shumë. Sipas tij, kjo situatë përbën kërcënim serioz për Agjencinë ashtu edhe për shërbimin publik. Ai theksoi se, përveç mundësisë që mjetet të kërkojnë në rrugë gjyqësore, institucioni nuk ka mekanizma të tjerë për veprim.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli kërkoi sqarim në lidhje me pikën e shpenzimeve për qiranë e objekteve të ndërtimit, përkatësisht për çfarë konkretisht synohen këto mjete.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunović, shpjegoi se qiraja i referohet tetë lokacioneve në qytete të ndryshme të vendit, ku Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ka instaluar pajisje për monitorim. Mjetet janë destinuar për qiranë e objekteve ose hapësirës ku ndodhen ato pajisje.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe pranoi Raportin mbi llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025 nr. 05-709/1 datë 23.2.2026 dhe njëzëri miratoi Vendim për miratimin e llogarisë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Në pajtim me nenin 19 të Ligjit për kontabilitet për organizatat jofitimprurëse, Llogaria vjetore dorëzohet në Zyrën e të ardhurave publike dhe në Regjistrin e llogarive vjetore në Regjistrin Qendror deri në fund të muajit shkurt të vitit pasardhës.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Drejtori Trajçevski shpjegoi propozim-Vendimin për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Top Estrada ShPKNJ P Tetovë. Ai shpjegoi se, në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, transmetuesi me kohë ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e lejes për periudhë prej nëntë vitesh të ardhshme. Në pajtim me dispozitat e ligjit, përcaktohet se janë përmbushur kushtet për vazhdimin e lejes, përkatësisht tek ky transmetues në periudhën e mëparshme nuk janë konstatuar shkelje ose ndalesa që do të paraqisnin pengesë ligjore për vazhdim. Prandaj, Këshilli i propozohet të miratojë vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Top Estrada ShPKNJ P Tetovë, PA1 nr. 08-182 datë 29.3.2017, me tekstin e propozuar, për periudhë prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 8.3.2026 deri më 7.3.2035.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Vendimi për vazhdimin e lejes për transmetimit televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Top Estrada ShPKNJ P Tetovë duhet t'i dorëzohet transmetuesit.

Pika 6

Drejtori Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizioni Koçani-LD ShPKNJ P Koçan. Ai shpjegoi se transmetuesit më 12 janar btë këtij viti i është dhënë faturë për kompensim vjetor për transmetim televiziv në shumën prej 127.146,00 denarësh. Në afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh, kompensimi nuk u pagua. Për shkak të mosrespektimit të detyrimit ligjor, propozohet të inicohet procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizija Koçani-LD ShPKNJ P Koçan, PA1 nr. 08-44 datë 7.9.2023 , për shkak të mospërbushjes së detyrimit të nenit 80, paragrafi 5 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht për mospagesë të kompensimit vjetor të lejes për transmetimit televiziv te Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr. 2026-100-0014 datë 12.1.2026.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciim të procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetimit televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizion Koçani-LD ShPKNJ P Koçan, PA1 nr. 08-44 datë 7.9.2023, për shkak të shkeljes së nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV.

Pika 7

Drejtori Trajçevski shpjegoi Informacionin mbi pagesën e anëtarësimit vjetor për vitin 2026 në Platformën Evropiane të Organeve Rregullatore (EPRA). Ai theksoi se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është anëtare e kësaj platforme të rëndësishme ndërkombëtare, e cila mundëson bashkëpunim, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave midis organeve rregullatore në fushën e medias. Anëtarësimi vjetor për 2026 është 4,182 euro, që paraqet rritje prej 82 eurosh krahasuar me vitin e kaluar. Duke pasur parasysh se ky është një detyrim financiar i Agjencisë, është e nevojshme që Këshilli të informohet dhe të japë pëlqim për pagesën e anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare.

Këshilli i Agjencisë njëzëri pranoi Informacionin mbi pagesën e anëtarësimit vjetor për EPRA për vitin 2026, nr. 05-246/2 datë 24.2.2026.

Spektori i financës dhe logjistikës do t'i paguajë mjetet në shumë prej 4,182 eurosh për anëtarësim vjetor të Agjencisë, Platformës Evropiane për Organet Rregullatore - EPRA për vitin 2026, jo më vonë se data 12.3.2026.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani